



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëhën/Prodato Received/Deavety	01.12.2023	3	viti god. year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKM/SHCK	7200/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1320/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetare Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1320/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi,

kundër organit të punësimit/Komunës së Deçanit, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1320/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me RN00011469 i datës 20.10.2023 i Udhëheqësit të Zyrës së Personelit në Komunën e Deçanit.

A r s y e t i m

Komuna e Deçanit me datë 24.04.2023 ka hap konkursin me numër të referencës RN00011469 për grup "Specialist Ligjor", për pozitën e punës "Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme", me mundësi aplikimi nga data 15.05.2023 deri me datën 25.05.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar tre (3) kandidatë.

Zyra e Personelit në Komunën e Deçanit me date 20.10.2023 kanë publikuar njoftimin me numër

referencës RN00011469 përmes të cilit kanë njoftuar se procedura me numër të referencës RN00011469 për grupin "Specialist Ligjor" ka përfunduar pa kandidate fitues dhe se kjo procedurë shpallet e dështuar.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin e datës 20.10.2023 të Zyrës së Personelit në Komunën e Deçanit me date 20.10.2023 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit. Ndërsa kjo e fundit përmes vendimit me numër NR.02/Zyrtarisht të datës 25.10.2023 ankesën e ankuesit e ka refuzuar si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit, me datë 24.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6663/2023 kundër njoftimit të datës 20.10.2023, me pretendim ankimor se vlerësimi në intervistën me gojë prej 0.8 pike nuk është i drejtë dhe se i njëjti kërkon që Komisioni i Vlerësimit në komunën e Deçanit të kontrollojë edhe njëherë vlerësimin e intervistës me gojë për tu siguruar që nuk kanë bërë gabime gjatë vlerësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Deçanit, ndërsa kjo e fundit më datë 02.11.2023 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6663/2023 të datës 24.10.2023; Vendimin me numër 02/Zyrtarisht të datës 25.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit; Ankesën (pa datë dhe numër) të parashtruar nga ankuesi tek organi i punësimit; Njoftimin e datës 20.10.2023 për përfundim të procedurës; Ankesë pa datë dhe numër; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 20.10.2023; Emalin e datës 24.10.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 01.11.2023; Konkursin e datës 24.04.203 me numër të referencës RN00011469 për grupin specialist Ligjor; Listën e aplikanteve (pa date dhe numër); Njoftimin për përfshirjen në listën e ngushte të datës 29.05.2023; Vendimin me numër NR.02/Zyrtarisht të datës 29.05.2023 të Zyrës së Personelit në Komunën e Deçanit; Njoftimin e datës 02.06.2023 për përfshirjen në listën e ngushtë; Vendimin me numër Nr.02/Zyrtarisht të datës 29.05.2023; Njoftimin për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 02.06.2023; Emalin e datës 26.06.2023 të drejtuar Emalin e datës 26.06.2023 të drejtuar Emalin e datës 06.07.2023 të drejtuar Emalin e datës 06.07.2023 të drejtuar Emalin e datës 06.07.2023 të drejtuar Rezultatit e vlerësimit të ankuesit të shkëputur nga sistemi SMBNJ; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 20.10.2023; Vendimin e datës 20.06.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 30.10.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 15.05.2023; Diplomën universitare me numër 229 të datës 11.01.2016; Certifikatën e datës 28.04.2023 lidhur me pjesëmarrjen e ankuesit në trajnimin "Dispozitat

Themelore për rregullimin e ndihmës shtatorë”; Certifikatën e datës 14.02.2023 lidhur me përfundimin e trajnimit “Menaxhimi i Kontratës përmes E-Prokurimit; Certifikatën e datës 25.11.20223 për pjesëmarrjen ne trajnimin Sjellje organizative; Certifikatën e datës 11.10.2022 lidhur me përfundimin trajnimit “Hartimi dhe përgatitja e deklaratave dhe kampanjave Informuese”; Certifikatën e datës 16.09.2022 lidhur me përfundimin e trajnimit “Mediat Sociale dhe Komunikimi Digjital” Certifikatën e datës 7.10.2020 lidhur me përfundimin e trajnimit “Procesi dhe teknikat për komunikim me publikun lidhur me zbatimin e detyrimeve nga MSA; Certifikatën e datës 13.09.2022 lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin “Administrimi i Punës ne Zyre”; Certifikatën me numër NR.2016/0103; Certifikatën e datës 11.09.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit Themelore Profesional; Certifikatën e datës 04.01.2011; Vërtetimin e datës 13.12.2017; Vërtetimin e punës 30.11.2021; Letër referencën e datës 27.09.2022; Letër referencën e datës 27.09.2022; Dokumentarin e identifikimit; Vërtetimin me numër të protokollit 792/19 të datës 09.07.2019; Certifikatën e datës 19.12.20223 mbi dënimet penale; Letër referencën e datës 27.09.2022; Trustin për periudhën kohore 16.12.2015 deri me datën 20.05.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni Vlerësues nuk e ka vlerësuar drejtë, në intervistën me gojë prej 0.8 pikë.

Në bazë të konkursit me numër reference RN00011469 për grup “Specialist Ligjor” kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: *Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit te larte me se paku 3 vite studime, ne fakultetin Juridik. Përvojë e punës e kërkuar: Se paku një (1) pune profesionale, duhet bashkangjitur vërtetimi i përvojës se punës, dhe Pasqyra e Trustit Pensional.*

Duke ju referuar provave të lëndës respektivisht renditjes përfundimtare të kandidateve Kolegji i Këshillit ka gjetur së Komisioni i Pranimit ka vlerësuar ankuesin në vlerësimin e testit me shkrim me pesëdhjetëdypikë (52) , ne vlerësimin e jetëshkrimit me pesëmbëdhjetëpikëkatërpikë (15.4) dhe ne intervistën me gojë ankuesi është vlerësuar me zeropikëtetëpikë (0.8), e që rezulton se ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë gjashtëdhjetëtetëpikëdy pikë (68.2) pikë.

Kolegji i Këshillit pas analizimit te Njoftimit të datës 20.10.2023 lidhur me përfundimin e procedurës se rekrutimit për konkursin me numër te referencës RN00011469 të datës 24.04.2023 për grupin “Specialist Ligjor”, ka gjetur se Udhëheqësi i Zyrës së Personelit me rastin e publikimit të njoftimit të lartpërmendur ka vepruar ne pajtim me nenin 25 paragrafin 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka përcaktuar se: *“2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar se paku me shtatëdhjetë 70 pikë, Komisioni i Pranimit, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit pa fitues. Njësia*

Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurrimit pa fitues, në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje''.

Kolegji i Këshillit po ashtu pas analizimit të vendimit të datës 25.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Shërbimin civil të Kosovës ka konstatuar se i njëjti është nxjerr në pajtim me nenin 25 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka përcaktuar se: "6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje. Andaj pretendimet e ankuesit të parashtruar në ankesën e datës 24.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës janë të pa bazuara.

Duke pasur parasysh se Konkursi me numër reference RN00011469 i datës 24.04.2023 pas vlerësimit të kandidateve nga ana e Komisionit të Vlerësimit në Komunën e Deçanit ka përfunduar pa kandidat fitues, Kolegji i Këshillit duke konsideruar si të bazuar vendimin e komisionit të pranimit e rrjedhimisht edhe njoftimin RN00011469 të datës 20.10.2023 i Udhëheqësit të Zyrës së Personelit në Komunën e Deçanit, nuk është lëshuar në çështje tjera që nuk ndërlidhen me objektin e kësaj ankese.

Bazuar në konstatimet si me lart, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1320/2023, datë 01/12/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

